



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

RAPORT

I KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

PËR VITIN 2020

Shkurt 2021



Përmbajtja

| | |
|--|----|
| Kuadri Ligjor dhe Institucional..... | 4 |
| Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si organ kushtetues: | 5 |
| Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si organ <i>ad hoc</i> i parashikuar me ligj..... | 6 |
| Në vitin 1997 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si organ i përhershëm..... | 6 |
| Zbatimi i rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2019 nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve..... | 10 |
| Burimet Njerëzore..... | 12 |
| NDRYSHIMET E STRUKTURËS DHE ORGANIGRAMËS TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE | 13 |
| Rekrutimi i personelit me kohë jo të plotë pune. | 16 |
| Përmbushja e detyrës me Institucionin e ILDKPI | 16 |
| Përmbushja e detyrës me Institucionin e ASPA..... | 16 |
| Përmbushja e detyrës me Institucionin e DAP | 16 |
| Administrim, arkivimi i dokumentacionit..... | 16 |
| Raportet financiare vjetore të partive politike për vitin 2019 | 17 |
| Auditimi i fondeve të partive politike për fushatën zgjedhore të vitit 2019..... | 18 |
| Buxheti i KQZ-së për vitin 2020 | 22 |
| Aktet e miratuara në KQZ, gjatë vitit 2020..... | 22 |
| Verifikimi formularëve të vetëdeklarimit të funksionarëve publik (dekriminalizimi) në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” për vitin 2020..... | 25 |
| Shqyrtime të rezultateve të verifikimeve të Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2020..... | 25 |
| Aktivitete me Partnerë Ndërkombëtarë | 26 |
| Administrimi i dokumentacionit zgjedhor, të zgjedhjeve vendore 2019..... | 28 |
| Edukimi i shtetasve të interesuar për çështje të administrimit zgjedhor..... | 28 |
| Plani i veprimeve, bazë orientuese për mbarëvajtjen e punës | 29 |
| Infrastruktura zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021..... | 30 |
| Bashkëpunimi me organet e vetqeverisjes vendore, marrja e informacionit për QV-të, zgjedhësit në to, hartat zgjedhore, QV-të në ambiente private..... | 31 |
| Aktet rregullatore për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve për Kuvendin të datës 25 Prill 2021..... | 32 |
| Akte të miratuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve..... | 33 |
| Për logjistikën zgjedhore | 34 |



Fjala përshëndetëse e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Të drejtat e qytetarëve për të votuar dhe për t'u zgjedhur në zgjedhje periodike janë të drejta të njohura ndërkombëtarisht. Konkurrimi zgjedhor është një shprehje e sovranitetit që i përket popullit dhe është shprehja e lirë e vullnetit të të cilit siguron bazën për autoritetin dhe legjitimitetin e qeverisë.

Zgjedhjet demokratike shërbejnë për të zgjidhur paqësisht konkurrencën për pushtet politik brenda një vendi dhe, në këtë mënyrë, janë thelbësore për paqen dhe stabilitetin. Zgjedhjet e mirëfillta të lira e të ndershme janë mjeti përmes të cilit njerëzit shprehin lirisht vullnetin e tyre, se kush do të ketë legjitimitetin për të qeverisur në emrin e tyre dhe në interes të tyre.

Në përputhje me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe instrumentet e tjerë ndërkombëtarë, të gjithë kanë të drejtën dhe mundësinë të marrin pjesë në qeverisje dhe çështjet publike të vendit të padiskriminuar dhe pa ndonjë kufizim të paarsyeshëm. Kjo e drejtë mund të ushtrohet drejtpërdrejt, duke konkurruar për funksione publike ose mund të ushtrohet përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.

Vullneti i lirë i njerëzve është baza për autoritetin e qeverisë, dhe ai vullnet duhet të përcaktohet përmes zgjedhjeve të mirëfillta periodike, të cilat garantojnë të drejtën dhe mundësinë për të votuar lirshëm dhe për t'u zgjedhur në mënyrë të drejtë përmes votës universal, të fshehtë dhe të barabartë.

Kur qeveritë legjitimohen përmes zgjedhjeve të vërteta demokratike, zvogëlohen hapësirat për sfida jodemokratike ndaj pushtetit. Realizimi i zgjedhjeve është pjesë e krijimit të proceseve të shumta dhe institucioneve të qeverisjes demokratike. Ato nuk mund të ndahen nga konteksti politik, kulturor dhe historik në të cilin zhvillohen.

Një vend nuk mund të arrijë zgjedhje demokratike nëse të drejtat dhe liritë e individit nuk mund të ushtrohen në mënyrë të vazhdueshme pa diskriminim në bazë të racës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik ose mendimit tjetër, origjinës kombëtare ose shoqërore, ose statusi tjetër, përfshirë ndër të tjera aftësi të kufizuara, dhe pa kufizime arbitrare dhe të paarsyeshme.

Ato, si të drejtat e tjera të njeriut dhe demokracia më gjerë, nuk mund të arrihen pa mbrojtjen e shtetit të së drejtës. Këto rregulla njihen nga të drejtat e njeriut dhe instrumente të tjerë ndërkombëtarë dhe nga dokumentet e organizatave të shumta ndërqeveritare.

Në këtë kontekst Komisioni Qendror i Zgjedhjeve luan një rol të rëndësishëm për administrimin dhe organizimin e Zgjedhjeve, dhe rrjedhimisht aktiviteti i tij udhëhiqet në zbatimin e këtyre parimeve.



Kuadri Ligjor dhe Institucional

Rrugëtimi i autoritetit më të lartë zgjedhor nga vitet '90 për të arritur në konfigurimin që kemi sot

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, i cili drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore, monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore dhe të medias në raport me zgjedhjet, si dhe zgjidh në rrugë administrative kërkesat apo ankesat që kanë lidhje me procesin zgjedhor

Baza ligjore për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar¹. Me ligjin nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, ndryshoi përbërja dhe funksionimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kështu, organet drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë:

- a) Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
- b) Komisioni Rregullator; dhe
- c) Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri) është organ monokratik, që ushtron kompetencat ekzekutive, drejton administratën e KQZ-së dhe përfaqëson KQZ-në në marrëdhëniet me të tretët.

Komisioni Rregullator (Rregullatori) është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet. Rregullatori funksionon me kohë të pjesshme dhe e ushtron veprimtarinë në mbledhje publike, të cilat thirren nga Komisioneri. Në rast se Komisioneri nuk vë në lëvizje Rregullatorin ose KAS-in kur ka çështje të kompetencës së tyre, atëherë organet vetëmbledhen me kërkesë të çdo anëtari.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) është organ kompetent për shqyrtimin e ankimimeve administrative dhe për vendosjen e sanksioneve për shkelje të ligjit zgjedhor. KAS-i funksionon me kohë të pjesshme dhe e ushtron veprimtarinë në seanca publike të shqyrtimit administrativ, të cilat thirren nga Komisioneri, me pjesëmarrjen e palëve të interesuara. Në rast se Komisioneri nuk vë në lëvizje Rregullatorin ose KAS-in kur ka çështje të kompetencës së tyre, atëherë organet vetëmbledhen me kërkesë të çdo anëtari.

Anëtarët e Rregullatorit dhe të KAS-it nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht detyra të tjera brenda organeve, institucioneve apo enteve, pjesë e pushtetit ekzekutiv.

Veprimtaria e KQZ-së, organeve drejtuese dhe e administratës udhëhiqet, sipas rastit, nga Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe nga ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Me ndryshimet e ligjit nr. 101/2020 ligjvënësi krijoi edhe një “institut” të ri, atë të Nënkomisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (nënkomisioneri) zgjidhet nga Kuvendi për një periudhë 4-vjeçare me detyrën

¹ Ligj nr. 74/2012, datë 10.07.2012; nr. 31/201, datë 02.04.2015; nr. 101/2020, datë 23.07.2020 dhe nr. 118/2020, datë 5.10.2020



për të monitoruar dhe mbikëqyrur implementimin e teknologjisë për identifikimin elektronik, rekrutimin dhe trajnimin e zyrtarëve zgjedhorë. Nënkomisioneri është përgjegjës për përcaktimin e zbatueshmërisë dhe drejton punën për zbatimin e projektit të identifikimit elektronik të votuesve. Ai bashkushtron me të drejta të barabarta me komisionerin kompetencat për përzgjedhjen, monitorimin dhe zbatimin e teknologjisë për identifikimin elektronik të zgjedhësve.

Zgjedhja e Komisionerit, anëtarëve të Rregullatorit dhe të KAS-it

Komisioneri, anëtarët e Rregullatorit dhe anëtarët e KAS-it zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me jo më pak se tre të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Paraqitja e kandidaturave bëhet nëpërmjet vetofrimit ose propozimit nga grupet parlamentare ose deputetët e veçantë. Për shqyrtimin dhe përzgjedhjen e kandidaturave, Kuvendi ngre komision të posaçëm parlamentar, me përfaqësim proporcional nga çdo grup parlamentar. Procedura e kandidimit dhe e përzgjedhjes së kandidaturave kryhet sipas dispozitave të rregullores së Kuvendit për zgjedhjen në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë nen. Komisioni i posaçëm parlamentar vlerëson me pikë kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj. Komisioni i paraqet Kuvendit për votim listën e kandidatëve, e cila përmban deri në 20 emra të kandidatëve kalues, me vlerësimin më të lartë. Për secilën kandidaturë të listës shënohet propozuesi dhe organizatat apo partitë politike mbështetëse, nëse ka. Në rast se Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Komisionerin, apo anëtarë të caktuar të Rregullatorit ose të KAS-it, me shumicën e kërkuar të votave sipas pikës të parë të këtij neni, atëherë administrata e Kuvendit hedh short midis të gjitha kandidaturave të paraqitura për votim Kuvendit për vendin përkatës. Fituesi i njoftohet Kuvendit dhe shpallet i zgjedhur në seancë plenare nga Kryetari i Kuvendit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si organ kushtetues:

Në vitin 1998, ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" pjesa e dymbëdhjetë "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve", në nenin 153 parashikonte Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si organ kushtetues, një organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe me referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.

Përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve parashikohet të jetë me 7 anëtarë, të cilët zgjidhen për një mandat 7-vjeçar. 2 anëtarë zgjidhen nga Kuvendi, 2 nga Presidenti i Republikës dhe 3 anëtarë të tjerë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përtërihet çdo tre vjet sipas procedurës së përcaktuar me ligj

Në vitin 2007, me ligjin nr.9675, datë 13.1.2007 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi të bëhen këto ndryshime në përbërjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (pika 1 e nenit 154 riformulohet si më poshtë):

"1. Komisioni përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët zgjidhen për një mandat 7-vjeçar.

2 anëtarë zgjidhen nga Kuvendi,



2 nga Presidenti i Republikës dhe

3 anëtarë të tjerë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë."

Në vitin 2008, me ligjin Nr.9904, datë 21.4.2008 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Neni 10, Pjesa e Dymbëdhjetë e Kushtetutës "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve" shfuqizohet. Pra, në vitin 2008, me ndryshimet Kushtetuese, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kalon nga organ kushtetues në një organ i krijuar me ligj (Kodin Zgjedhor) me një përbërje të emëruar nga Kuvendi i Shqipërisë sipas formulës së parashikuar nga Kodi Zgjedhor dhe të përshkruar mësipër.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si organ *ad hoc* i parashikuar me ligj

Në vitin 1992, ligji nr. 7556, datë 4.2.1992, neni 34, parashikon se për drejtimin e zgjedhjeve të Kuvendit Popullor ngrihen: a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; b) komisionet e zgjedhjeve të zonave; c) komisionet e qendrave të votimit. Në komisionet e zgjedhjeve marrin pjesë përfaqësues të subjekteve elektorale, si dhe persona pa parti. Komisionet e zgjedhjeve janë organizma të pavarur, që në veprimtarinë e tyre i nënshtrohen vetëm ligjit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (neni 35) përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe 14 anëtarë. Përbërja e Komisionit Qendror vendoset nga Presidenti i Republikës me propozimin e partive politike, jo më vonë se 35 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Partitë politike që nuk kanë anëtarë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues.

Sikurse vihet re korniza ligjore që rregullon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në vitin 1992 është paraparë si një strukturë *ad hoc* që ngrihet dhe funksionon vetëm për periudhën zgjedhore, jo më vonë se 35 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Është një strukturë që burimin e ka tek partitë politike.

Në vitin 1996, Ligji nr. Nr.8055, datë 1.2.1996 "Për Ndryshimet në Ligjin Nr.7556, datë 4.2.1992 "Për Zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë", neni 19, paragrafi i dytë i nenit 35,"Përbërja e Komisionit Qendror vendoset nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Këshillit të Ministrave dhe të partive politike që kanë paraqitur lista elektorale për ndarjen e mandateve shtesë, jo më vonë se 45 ditë përpara ditës së zgjedhjeve".

Sikurse vihet re, vetëm 4 vite më vonë, pra në vitin 1996 ka një ndryshim në formatimin ligjor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Sërisht është Presidenti i Republikës që vendos përbërjen e kësaj strukture zgjedhore por tashmë mbi propozimin e Këshillit të Ministrave dhe të partive politike që kanë paraqitur listat elektrale për ndarjen e mandateve shtesë.

Në vitin 1997 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si organ i përhershëm

- Me ligjin Nr. 8218, datë 16.5.1997 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7556, datë 4.2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit



Popullor të Republikës së Shqipërisë", ka ndryshuar sërish përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (neni 15 dhe vijuesa), parashikohet se për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve funksionojnë:

a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; b) Komisionet e zgjedhjeve të zonave; dhe c) Komisionet e qendrave të votimit;

Komisionet e zgjedhjeve janë organizma të pavarur që në veprimtarinë e tyre i nënshtrohen vetëm ligjit. Veprimtaria e ushtruar prej anëtarëve të komisioneve është veprimtari shtetërore dhe jo politike.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Shqipërisë është organ i përhershëm, i cili drejton dhe kontrollon zhvillimin e zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat ligjore elektorale të shtetit shqiptar.

- Komisioni përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe 14 anëtarë.
- Propozimet për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve i dërgohen Presidentit të Republikës nga partitë politike.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ushtron veprimtarinë e tij për një periudhë 7-vjeçare.
- Anëtarët e tij gëzojnë të drejtën e riemërimit. Partitë politike që nuk kanë anëtarë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues.

"Kryetari dhe zëvendëskryetari i Komisionit Qendror të Përhershëm të Zgjedhjeve propozohen përkatësisht nga partitë kryesore të "pozitës dhe të opozitës, të zgjedhur nga radhët e personelit shkencor universitar. Zëvendëskryetari gëzon pozitë juridike të barabartë me kryetarin. Në rast se ndonjëra nga këto parti nuk paraqet kandidaturë për kryetar ose zëvendëskryetar, atëherë ky vend i jepet partisë vijuese brenda grupimit pozitë-opozitë.

Vendet e anëtarëve të komisionit ndahen në mënyrë të barabartë midis partive politike pjesëtare të koalicionit qeveritar dhe të opozitës. Brenda këtyre ndarjeve, vendet në komision zihen nga përfaqësuesit e partive politike në përpjesëtim me rezultatet e arritura prej tyre në zgjedhjet për organet e pushtetit lokal.

Në vitin 2000, me ligjin nr. 8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", me Nenin 16 "Cilësitë e anëtarëve", 1. Anëtarët e KQZ-së duhet të kenë njohuri dhe përvojë profesionale në njërin nga këto fusha:

- të së drejtës,
- të administrimit të zgjedhjeve,
- të administratës publike ose të marrëdhënieve publike.

Anëtar i KQZ-së zgjidhet shtetasi shqiptar me vendbanim në Shqipëri, që plotëson këto kushte:

- a) Gëzon të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.
- b) Është me arsim të lartë.
- c) Nuk është dënuar për kryerjen e një krimi me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- c) Nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të një partie politike gjatë tre vjetëve të fundit.



Zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së bëhet sipas prashikimeve të nenit 154 të Kushtetutës. Kështu, Presidenti i Republikës emëron dy anëtarë të KQZ-së pas konsultimeve me grupe që përfaqësojnë një spektër të gjerë të shoqërisë.

Kuvendi zgjedh dy anëtarë të KQZ-së në bazë të propozimeve të Byrosë së Kuvendit, e cila harton dy lista me nga tre emra të propozuar nga grupet e opozitës dhe të shumicës parlamentare Këshilli i Lartë i Drejtësisë zgjedh me votim të fshehtë tre anëtarë të KQZ-së në bazë të propozimeve të Konferencës Gjyqësore Kombëtare dhe të kandidaturave individuale; të gjitha propozimet dhe kandidaturat bëhen publike.

Konferenca Gjyqësore Kombëtare propozon 6 juristë, të paktën njëri prej të cilëve zgjidhet anëtar i KQZ-së. Pra sikurse vihet re ka një përpjekje të politikës shqiptare në vitet 2000 që të ketë një lloj distance nga përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe kjo vihet re nga fakti se i lihet diskrecion zgjedhjeje Presidentit të Republikës i cili do të duhet të respektojë një procedurë. I lihet diskrecion propozimi Konferencës Gjyqësore Kombëtare si edhe Kuvendit të Shqipërisë.

Në vitin 2003, ligji Nr.9087, date 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, pjesa e tretë Organizimi dhe funksionimi i KQZ-së kreu 1, parashikon se zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së, bëhet si më poshtë:

Kuvendi i Shqipërisë zgjedh dy anëtarë të KQZ-së në bazë të propozimeve respektive nga spektri i majtë dhe i djathtë i përbërjes politike të tij, përjashtuar partinë më të madhe të secilit spektër politik. Numri i kandidaturave që i paraqiten Kuvendit të Shqipërisë nuk është më i madh se dy për secilin vend vakant. Kandidaturat brenda grupimeve përzgjidhen me konsensus ose sipas numrit të votave mbështetëse të deputetëve që i përkasin të njëjtit spektër të propozuesit, përjashtuar partinë më të madhe të spektrit përkatës. Një deputet nuk duhet të mbështesë më shumë se një listë kandidaturash. Kandidaturat e propozuara i paraqiten Kuvendit nga Kryetari i tij.

Presidenti i Republikës emëron dy anëtarë të KQZ-së, në bazë të propozimeve respektive të dy partive më të mëdha të pozitës dhe opozitës. Numri i kandidaturave të propozuara nuk është më i madh se dy për secilin vend në KQZ. Këshilli i Lartë i Drejtësisë zgjedh tre anëtarë të KQZ-së, sipas kësaj procedure:

- a) dy anëtarë të KQZ-së miratohen me nga dy kandidatura të propozuara respektivisht nga dy partitë më të mëdha;
- b) për kandidatin e tretë Këshilli i Lartë i Drejtësisë ndjek këtë procedure: Dy grupet më të mëdha parlamentare propozojnë nga katër kandidatura me profesionin jurist. Secili prej grupeve parlamentare përzgjedh dy nga katër kandidaturat e grupit tjetër. Katër kandidaturat e përzgjedhura i paraqiten Këshillit të Lartë të Drejtësisë për votim jo me vone se 48 ore nga depozitimi i tyre. Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Nëse asnjë kandidat nuk arrin shumicën e kërkuar, zhvillohet raundi i dytë në të njëjtën ditë midis dy kandidatëve që marrin më shumë vota në raundin e parë. Nëse edhe në raundin e dytë asnjë kandidat nuk merr dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, atëherë zhvillohet raundi i tretë në të njëjtën ditë midis dy kandidatëve të raundit të dytë. Në raundin e tretë fiton kandidati që merr 50 për qind plus 1 të votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.



- Dhe së fundi, është është ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, ligji i cili aktualisht rregullon organizimin dhe funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas përshkrimit të rugëtimit të formatimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të funksioneve të tij nga fillimi i viteve '90 e deri në ditët tona, konstatohet se ka qenë në fokusin dhe në vëmendjen e ligjvënësit shqiptar në vazhdimësi duke u përparuar në ruajtjen e balancave drejt standardeve që ofrohen nga praktikatat më të mira ndërkombëtare. Në këtë drejtim, interesant është fakti që në vitin e vështirë 1997, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kthehet në një institucion kushtetues të përhershëm. Fakti që në periudha të caktuara ka shprehur vullnetin nga ligjvënësi që detyra pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe strukturave në varësi të tij duhet konsideruar si detyrë shtetërore dhe jo si detyrë partiake, tregon tendencat e mirëfillta për ta vendosur funksionimin e këtij organi të rëndësishëm mbi bazat administrative e shtetërore.

Parimet udhëzuese të rekomandueshme në përputhje me standartet demokratike të vendeve të zhvilluara për trupat e menaxhimit zgjedhor dhe që praktikisht synon t'i praktikojë edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve janë: pavarësia, paaanshmëria, integriteti, transparenca, efikasiteti, profesionalizmi, mendësia ndaj shërbimit.



Zbatimi i rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2019 nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Në përmbushje të detyrave të përcaktuara në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë të datës 21.5.2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për shkak të organizimit të ri të KQZ-së, me shpalljen e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11700, datë 06.09.2020, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin", ka hartuar program pune për vitin 2020 dhe 2021 me qëllim planifikimin e aktiviteteve që do t'i parapranin organizimit të Zgjedhjeve për Kuvendin të datës 25 prill 2021.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka vijuar zbatimin e drejtë dhe në referim të dispozitave ligjore të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" duke përmirësuar cilësinë e vendimarrjes me ndryshimet që shoqëruan Kodin Zgjedhor, për këtë kategori aktesh duke miratuar akte individuale për cdo zëvendësim vakance.

Zhvillimet politike që shoqëruan ndryshimet në Kodin Zgjedhor me marreveshjen e Këshillit Politik, ndryshimi i arkitekturës drejtuese të KQZ-se, konstituimi i ketyre organeve 3 mujorin e fundit të vitit 2020 ndikuan në vonimin e procesit të hartimit dhe miratimit të Kodit Etik. Hartimi i këtij akti është përfshirë në planin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2021.

Në zbatim të kërkesës së Kuvendit të Shqipërisë, përmes Rezolutës "Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2019", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në shqyrtimin e të dhënave të administratës zgjedhore, ka përpunuar konkluzionet si më poshtë:

- Sjellja politike e subjekteve zgjedhore, ndikon opinionin publik sa i përket paanshmërisë dhe paanësisë së administratës zgjedhore të nivelit të dytë (KZAZ), kjo në vështrim të të drejtave që Kodi Zgjedhor i njeh për zëvendësimin e anëtarëve dhe sekretarëve.

Numri i madh i zëvendësimeve të komisionerëve, veçanërisht në muajin e zgjedhjeve, lëkund besimin e publikut në paanshmërinë e administrimit të procesit zgjedhor. Zëvendësimi i anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve, edhe në ditën e zgjedhjeve, kur KQZ ka përmbyllur kalendarin e trajnimeve, cënon mirëadministrimin e procesit, për shkak të mosnjohjes së procedurave nga anëtarët e pa trajnuar. Kjo sjellje, e përsëritur në të gjithë proceset zgjedhore, bën të pamundur zbatimin rigoroz të Kodit Zgjedhor, ku mospjesëmarrja në trajnim apo mos kalimi i testit të njohurive, përcaktohet si një nga shkaqet për shkarkimin nga detyra të anëtarit apo sekretarit të KZAZ. Duke referuar të dhenat, numri i zëvendësuar anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve me kërkesë të partive politike, paraqitet si më poshtë:

146 ose 28%, në zgjedhjet për Kuvendin 2009;

140 ose 26%, në zgjedhjet vendore 2011;



253 ose 36%, në zgjedhjet për Kuvendin 2013;

271 ose 38%, në zgjedhjet vendore 2015;

131 ose 18%, në zgjedhjet për Kuvendin 2017;

108 ose 18%, në zgjedhjet vendore 2019 (*Shifrat i referohen vetëm subjektit zgjedhor që paraqiti propozime për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve*).

- Sjellja politike e subjekteve zgjedhore, për propozimet jashtë afateve ligjore të anëtarëve të administratës zgjedhore të nivelit të tretë (KQV dhe GNV), cënon organizimin, administrimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Propozimet e për rrjedhojë emërimet e anëtarëve të KQV-ve, në javën e fundit para datës së zgjedhjeve, e në jo pak raste një ditë para datës së zgjedhjeve, sjellin për pasojë realizimin e trajnimeve jo sipas standarteve të përcaktuara, duke cënuar profesionalizmin e komisionerëve në zbatimin e procedurave gjatë ditës së zgjedhjeve.

Duke referuar të dhënat, rezultojnë se kanë emëruar anëtarët e KQV një ditë para datës së zgjedhjeve, 28 KZAZ në zgjedhje vendore 2015, dhe 13 KZAZ në zgjedhje për Kuvendin 2017. Emërimet e vonuara cënojnë në mënyrë thelbësore skemën e trajnimit e planifikuar nga KQZ, vetëm në ditët e fundit të trajnimeve ka pjesëmarrje të komisionerëve, duke shkaktuar tejkalim të numrit të parashikuar për sesion, reduktim të interaktivitetit për diskutim dhe qartësim të procedurave.

KQZ, me shqetësim vlerëson problematikën që shkakton mospjesëmarrja në trajnim e anëtarëve të emëruar KQV-ve. Referuar të dhënave, rezulton se rreth 50 % e anëtarëve të KQV ushtrojnë detyrën pa u trajnuar. Mosnjohja e procedurave përbën shkak për shkelje të ligjit, debate mes komisionerëve, vonesa në hapjen e qendrave të votimit, vonesa në fillimin e votimit, madje edhe në pezullim të votimit për të korrigjuar parregullsitë e shkaktuara në administrimin e materialit zgjedhor nga komisionerë të patrajnuar.

Më problematike paraqitet sjellja e subjekteve zgjedhore sa i përket propozimeve të anëtarëve të grupeve të numërimit të votave, që përgjithësisht kryhen para fillimit apo dhe gjatë procesit të numërimit të votave. Për shkak të emërimeve të vonuara, trajnimi i anëtarëve të GNV kryhet përgjithësisht para fillimit të procesit të numërimit, në VNV, ndërkohë që merren në dorëzim materialet zgjedhore, në kohë të kufizuar dhe atmosferë jo të qetë. Për këtë shkak, cënohet profesionalizmi i numëruesve, duke sjellë problematika në proces, të cilat përbëjnë shkak edhe për debate, situata dhe zgjatje të panevojshme të tij.

- Sjellja e subjekteve zgjedhore sa i përket raportit gjinor në propozimet për anëtarët e administratës zgjedhore:

Në komisionet e nivelit të dytë (KZAZ), për shkak të kuotës gjinore të përcaktuar në Kodin Zgjedhor, përfaqësimi i grave shënon tendencë në rritje. Partitë politike që kanë detyrimin e kuotës gjinore në propozimet për anëtarë të KZAZ-ve, e



respektojnë atë në propozimet e para, edhe në zëvendësimet në vijim. Megjithatë, ky përcaktim, nuk realizon përfaqësimin 30% të grave në çdo KZAZ: në zgjedhjet vendore 2015, në 58 KZAZ përfaqësimi i grave ishte nën 30%, në zgjedhjet për Kuvend 2017, në 57 KZAZ përfaqësimi i grave ishte nën kuotën 30%.

Për nivelin e III-të të administratës zgjedhore, komisionet e qendrave të votimit dhe grupet e numërimit të votave, për të cilat Kodi Zgjedhor nuk përcakton detyrim për kuotë gjinore, sjellja e partive politike dëshmon probleme lidhur me qasjen ndaj gjinisë më pak të përfaqësuar. Në zgjedhjet vendore 2015, 51% e KQV në rang vendi nuk kishte asnjë grua në përbërje, 40 % e KQV kishin përfaqësim të grave nën 30%, dhe vetëm 9% e KQV kishin përfaqësim të grave mbi 30 %. Në zgjedhjet për Kuvend 2017, nga 37 534 anëtarë të komisioneve të qendrave të votimit, 5 814 ose 15.5% e tyre ishin gra, dhe nga 3464 anëtarë të Grupeve të Numërimit të Votave, 422 ose 12.2 % e tyre ishin gra.

Burimet Njerëzore

Drejtorja e Burimeve Njerëzore është pjesë përbërëse e strukturës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ku detyrat dhe objektivat janë; ruajtja dhe zhvillimi i burimeve njerëzore, rekrutimi i një stafi profesional e të kualifikuar, trajnimi i vazhdueshëm me qëllim forcimin e performancës, si dhe përmirësimin e aftësive menaxheriale dhe drejtuese, me qëllim arritjen e detyrave dhe objektivave për të mbështetur misionin e Institucionit.

Gjatë vitit 2020:

Njësia Përgjegjëse në bazë të ligjit nr.152, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dalta në zbatim të tij, ka ndjekur këto procedura:

- Procedurë për “Pezullim” në kategorinë e mesme drejtuese, përkatësisht për pozicionin e punës, Drejtor në Drejtorinë e
- Logjistikës Zgjedhore.
- Procedurë për “Dorëheqje” në kategorinë ekzekutive, përkatësisht për pozicionin e punës, Specialist/IT në Drejtorinë e Teknologjisë së informacionit.

❖ Në zbatim të “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Rekrutimin i punonjësve me kohë jo të plotë pune 5 (pesë) operatorë, për zbatim të marrëveshjes së nënshkruar mes KQZ dhe DPA për përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve të KQZ-së.
- Rekrutim i punonjës me kohë jo të plotë pune 50 (pesëdhjetë) bazuar në vendimin e KQZ nr.4, datë 21.02.2020 “Për miratimin e mënyrës së asgjësimit të fletëve të votimit, administrimin e dokumentacionit zgjedhor dhe shpenzimeve buxhetore për hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019”.



- Ndërprerje të marrëdhënieve të punës 1 (një) punonjëse për shkak të mbushjes së moshës së pensionit dhe zëvendësimit e saj.

Ndryshimet e strukturës dhe organigramës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kuvendi i Shqipërisë në korrik 2020, miratoi ndryshimet në ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, i cili sollti ndryshime thelbësore në organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Organizimi i ri i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si institucion me tre organe drejtuese dhe shpërndarja e kompetencave në këto tre organe, diktoi nevojën e riorganizimit të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që nënkupton suprimimin e disa njësive, bashkimin, ndarjen apo krijimin e njësive të reja administrative edhe në funksion të ushtrimit të funksioneve të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në paragrafin “m”, neni 19, të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, përgatiti dhe i përcolli për miratim Kuvendit të Shqipërisë strukturën dhe organikën e administratës së KQZ-së me kohë të plotë pune.


Kuvendi me vendim 67/2020 miratoi strukturën organikën dhe klasifikimin e pagave të punonjësve me kohë të plotë pune, gjithsej 85 punonjës, nga të cilët 65 punonjës janë pjesë e shërbimit civil dhe 20 punonjës mbështetës. Për funksionimin dhe përmbushjen e detyrave që burojnë nga Kodi Zgjedhor, nëpunësit e administratës së KQZ-së, janë organizuar si më poshtë:

| | | |
|---|--|--|
| Kabineti i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve | | Drejtor Këshilltar Zëdhënës Sekretare |
| Sekretari Përgjithshëm | | |
| Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve | | |
| Drejtoritë | Sektorët | Numri i punonjësve për drejtori |
| Drejtoria e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore | <ul style="list-style-type: none"> ○ Sektori i Trajnimeve ○ Sektori i Koordinimit dhe Mbikëqyrjes ○ Sektori i Mjeteve dhe Materialeve Zgjedhore | 12 |




| | | |
|--|---|----|
| Drejtoria e Administrimit të të Dhënave dhe të Sistemeve IT | <ul style="list-style-type: none"> o Sektori i Administrimit të të Dhënave dhe të Sistemeve o Sektori i Votimit të Emigrantëve | 10 |
| Drejtoria e Komunikimit | <ul style="list-style-type: none"> o Sektori i Programit të Edukimit të Zgjedhësve o Sektori i Vëzhgimit dhe Koordinimit Ndërkombëtar | 7 |
| Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore, Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse | | |
| Drejtoria Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor | <ul style="list-style-type: none"> o Sektori i Përgatitjes së Akteve o Sektori i Verifikimit të Dokumenteve dhe Këshillimit Ligjor mbi ankesat administrative dhe Gjyqësore o Sektori i Dekriminalizimit | 13 |
| Drejtoria e Kontrollit Financiar dhe Auditit të Brendshëm | <ul style="list-style-type: none"> o Sektori i Kontrollit Financiar o Sektori i Auditit të Brendshëm | 7 |
| Drejtoria e Buxhetit dhe Financës | | 4 |
| Drejtoria e Burimeve Njerëzore | <ul style="list-style-type: none"> o Sektori i Administrimit dhe Arkivimit të Dokumentacionit o Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Përgjithshme | 21 |





Në strukturën e re, vërehen ndryshime në emërtesa dhe organizime të drejtorive dhe sektorëve, në ndryshim me strukturën e vitit 2002, të ndryshuar, të cilat janë pasqyruar më poshtë;



Drejtorja e Burimeve Njerëzore në zbatim të nenit 50, pika 3, të ligjit nr.152, datë 30.05.2013, “Për Nëpunësit Civil”, i ndryshuar, kreut II, të vendimit nr.125, të Këshillit të Ministrave, datë 17.02.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, si dhe udhëzimit nr.1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të riskstrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit” me qëllim implementimin e strukturës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Me nxjerrjen e aktit për krijimin e komisionit të Ristrukturimit filluan procedurat e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë.

Për plotësimin e vendeve të lira në bazë të strukturës së re, njesia përgjegjëse ka përfunduar procedurat e testimit sipas përcaktimit të ligjit për statusin e nëpunësit civilë për:



- 2 (dy) pozicione pune nivel i mesëm drejtues;
- 5 (pesë) pozicione pune të kategorisë ekzekutive.

Rekrutimi i personelit me kohë jo të plotë pune.

Me qëllim për të mbështetur stafin e përhershëm në përmbushjen e detyrave të përcaktuar në Kodin Zgjedhor si dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, me vendimin nr.69/2020 të Kuvendit të Shqipërisë u miratua struktura, organika dhe klasifikimi i pagave të personelit me kohë jo të plotë pune që rekrutohet për periudhën zgjedhore.

Përmbushja e detyrës me Institucionin e ILDKPI

Bazuar në ndryshimet e Kodit Zgjedhor dhe ndryshimeve të strukturë-organikës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, autoriteti përgjegjës ka përmbushur detyrimin ligjor dhe për subjektet deklaruese të pasurisë, për zyrtarët që janë larguar nga funksioni dhe zyrtarët që deklarojnë para fillimit të detyrës, nga ku rezulton që të gjithë zyrtarët e kanë dorëzuar deklaratën përkatëse. Gjithashtu, autoriteti përgjegjës mbart detyrimin ligjor për të raportuar veprimtarinë vjetore të punës së tij, lidhur me ushtrimin e kompetencave ligjore, ndjekjen e hapave të vazhdueshme në plotësimin e detyrave përkatëse.

Përmbushja e detyrës me Institucionin e ASPA

Gjatë 2020, nëpërmjet një korrespondence të vazhdueshme me ASPA-n, me objekt "Për vlerësimin e nevojave për trajnim" me kërkesë të punonjësve janë ndjekur trajnime on - line për rritjen e kapaciteteve profesionale duke iu përshtatur pozicioneve të punës, motivimit të punonjësve, përditësimet me legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu është ndjekur dhe zbatimi i programit të trajnimit për punonjësit në periudhë prove.

Përmbushja e detyrës me Institucionin e DAP

Për sa i përket procesit të vetëdeklarimit pranë DAP-it në kuadër të ligjit për dekriminalizimin të gjithë nëpunësit civilë që kanë pasur detyrimin për të plotësuar formularin e kanë dorëzuar pranë DAP-it në afatin e kërkuar.

Zhvillimin e Regjistrit Qendror të Personelit (HRMIS) duke e përditësuar me strukturat, organikat dhe hedhjen e të dhënave të dosjes individuale të të punësuarve.

Administrim, arkivimi i dokumentacionit

Sektori i Administrimit dhe Arkivimit të Dokumentacionit (SAAD), ka koordinuar punën brenda sektorit për protokollimin, evidentimin, administrimin, sistemimin, inventarizimin dhe skanimin e dokumentacionit që hyn dhe del nga institucioni në bazë të rregullave të përcaktuara në "Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve" dhe ligjit për Arkivat.

Është kryer zbardhja e materialeve audio të mbledhjeve të tre organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të



publikuara në faqen e ëeb-it të KQZ-së.

Në zbatim të vendimit të KQZ-së nr.4, datë 21.02.2020, u kryen procedurat ligjore për hapjen e kutive të votimit për kryetar/anëtarë këshilli dhe kutive të materialeve zgjedhore, administrimin e dokumentacionit zgjedhor si dhe asgjesimit të fletëve të votimit.

Hapja e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore, u bazua në kriterin e seleksionimit dhe administrimin e dokumentacionit zgjedhor të parashikuar në nenin 178, të Kodit Zgjedhor, i cili do t'i dërgohet Arkivit Qendror të Shtetit. Dokumentacioni i gjetur në kutinë e materialeve zgjedhore është sjellë rregullisht në Zyrën e Arkivës në KQZ, në bazë qarku/ZAZ/QV, ku është realizuar një verifikim dhe organizim i dytë i tij dhe më pas është regjistruar në inventarin përkatës. Numërtimi i dokumentacionit është bërë për çdo fletë të: listës së zgjedhësve, regjistrin të posaçëm, librit të protokollit, PV-07, PV-08, si pjesë e sistemit të dokumentimit të procesit të administrimit të dokumentacionit. I gjithë dokumentacioni është administruar në dosje më vete, duke identifikuar numrin e QV-së, ZAZ-së, qarkun që i korrespondon, numrin e fletëve të administruara dhe afatin e ruajtjes.

Dokumentacioni zgjedhor, duke përfshirë; listat shumëmemërore të kandidatëve për kryetar dhe anëtar të këshillave bashkiak, tabelat e rezultateve, vendimet e emërimit të anëtarëve, kryetarëve, zv/kryetarëve është organizuar dhe sistemuar në mënyrën e kërkuar nga Arkivi Qendror i Shtetit. Gjithsej janë dorëzuar në Arkivin Qendror 433 kuti kartoni, të sistemuara në 6533 dosje të thjeshta me numër fletësh të numërtuara 290310.

DREJTORIA E BUXHETIT DHE E FINANCËS

Raportet financiare vjetore të partive politike për vitin 2019

Në zbatim të Ligjit nr.10374, datë 10.02.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar, partitë politike dorëzojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve raportet financiare, sipas modelit të raportit financiar miratuar me vendim nga KQZ.

Data 31 mars e vitit pasardhës, është afati i dorëzimit të raportit financiar, përcaktuar nga KQZ me vendimin nr. 14, datë 23.11.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.3, datë 18.01.2012 “Për miratimin e rregullave për formatet e standardizuara për raportimet financiare të partive politike, subjekteve zgjedhore dhe raportimet e kontrollit financiar të ekspertëve kontabël”.

Për vitin kalendarik 2019, nga 128 parti politike të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kanë dorëzuar raportet financiare vjetore në KQZ, vetëm 26 parti politike, si më poshtë:

1. Partia Kristian Demokrate
2. Partia Socialdemokrate e Shqipërisë
3. Partia Demokratike e Shqipërisë
4. Partia Lëvizja Socialiste për Integrim



5. Partia Socialiste e Shqipërisë
6. Partia Lëvizja Punëtoresh Shqiptare
7. Partia e Punës së Shqipërisë
8. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut
9. Partia Lista e Barabartë
10. Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen
11. Partia Bashkimi Liberal Demokrat
12. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet
13. Partia Zgjidhja
14. Partia Demokracia Sociale
15. Partia Demokristiane e Shqipërisë
16. Partia Liri Demokraci dhe Etikë
17. Partia për Europeanizim dhe Integrim e Shqipërisë
18. Partia Lëvizja e Legalitetit
19. Partia Fryma e Re Demokratike
20. Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet
21. Partia Ora e Shqipërisë
22. Partia Balli Kombëtar
23. Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar
24. Partia Socialiste e Moderuar
25. Partia Republikane Shqiptare
26. Partia Aleanca Demokratike Shqiptare

Raportet finaciare të partive politike për vitin 2019 janë publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së, ne linkun: <http://cec.org.al/raportet-vjetore-financiare-te-partive-politike/>

Auditimi i fondeve të partive politike për fushatën zgjedhore të vitit 2019

Më 30 qershor 2019 u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Në vitin zgjedhor, mbikqyrja financiare e partive politike, fillon me rregjistrimin e subjekteve zgjedhore në zgjedhje, emërimin e audituesve ligjorë dhe ekspertëve financiarë për monitorimin e fushatës, monitorimi i shpenzimeve të fushatës zgjedhore, dhe vazhdon me hartimin dhe dorëzimin e raporteve financiare nga partitë politike, audituesit ligjorë dhe monitoruesit e shpenzimeve të fushatës, publikimin e raporteve financiare, dhe përfundon me verifikimin e raporteve dhe vendosjen e sanksioneve, për rastet e shkeljeve të konstatuara. Gjatë periudhës prill- qershor 2019, u rregjistruan si subjekt zgjedhor gjithsej 36 parti politike, të cilat morën pjesë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2019. KQZ emëroi 34 auditues ligjorë, të cilët do të



kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e organeve vendore të vitit 2019 (vendimi i KQZ-së nr.740, datë 31.05.2019).

Ekspertët financiar kishin detyrimin të depozitonin në KQZ çdo javë raportet e ndërmjetme për rezultatet e monitorimit të fushatës zgjedhore. Në përfundim u dorëzuar në KQZ: 33 raporte monitorimi të ndërmjetëm për javën e parë të fushatës zgjedhore, 34 raporte monitorimi të ndërmjetëm për javën e dytë të fushatës zgjedhore, 34 raporte monitorimi të ndërmjetëm për javën e tretë të fushatës zgjedhore dhe 31 raporte monitorimi të ndërmjetëm për javën e katërt të fushatës zgjedhore. KQZ ka publikuar në faqen zyrtare të internetit raportet e monitorimit të ndërmjetëm të fushatës zgjedhore në adresën: <http://cec.org.al/raporte-te-monitorimit-te-fushates-zgjedhore/>

Afati i fundit i dorëzimit të raporteve financiare për fushatë zgjedhore 2019, nga ana e partive politike pjesmarrëse në zgjedhje, ishte data 26.09.2019 (jo më vonë se 60 ditë nga shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve). 22 parti nga 36 parti që ishin regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhje, dorëzuan në KQZ raport financiar për fushatën zgjedhore. KQZ publikoi në faqen zyrtare të internetit raportet financiare të fushatës zgjedhore në adresën: <http://cec.org.al/raportet-financiare-fushaten-zgjedhore-2019/>

Në bazë të vendimit nr.740 datë 31.05.2019 u emëruan 34 ekspertë të cilët monitoruan dhe audituan 36 parti politike për fondet dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore 2019 dhe 16 kandidatë të mbështetur nga zgjedhësit.

Afati i fundit i dorëzimit të raporteve të monitorimit përfundimtar nga ekspertët financiarë ishte data 26.11.2019 (jo më vonë se 4 muaj nga data e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve). Ekspertët financiar kanë depozituar në KQZ 35 raporte të monitorimit përfundimtar të fushatës zgjedhore. KQZ publikoi në faqen zyrtare të internetit raportet financiare të fushatës zgjedhore në adresën:

<http://cec.org.al/raportet-e-monitorimit-perfundimtar-te-fushates-zgjedhore-2019/>

Afati i fundit i dorëzimit të raporteve të auditimit të fushatës zgjedhore ishte data 16.12.2019 (jo më vonë se 20 ditë nga dorëzimi i raportit të monitorimit përfundimtar). Audituesit kanë dorëzuar në KQZ 35 raporte auditimi. Audituesit kanë certifikuar financimin e fushatës zgjedhore për 35 parti politike. KQZ ka publikuar në faqen zyrtare të internetit raportet auditimit të fushatës zgjedhore në adresën: <http://cec.org.al/raportet-e-auditimit-te-partive-politike/>

Fondet për auditimin financiar të fushatës dhe për monitorimin e shpenzimeve të fushatës, (pagesa e audituesve ligjorë) mbulohet nga buxheti i shtetit. KQZ me vendimin nr.740, datë 31.05.2019 “Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve financiar dhe audituesve ligjorë të cilët do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019”, përzgjedhi me short dhe emëroi 34 ekspertë kontabël për auditimin e fondeve të perfuturara dhe të shpenzuara nga 36 parti politike gjatë vitit 2019.

KQZ administroi raportet e auditimit dhe raportet e auditimit të audituesve ligjorë, dhe përgatiti materialin mbi bazën e



opinionit të shprehur prej tyre. Në përfundim të procesit të verifikimit të raporteve të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin 2019, rezultoi se: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbështetje të nenit 21, pika 15, nenit 91 të Kodit Zgjedhor, nenit 15/2, pika 1 i ligjit nr.8580 datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, ndryshuar me ligjin nr.90/2017, datë 22.05.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580 “Për Partitë Politike”, është organi përgjegjës për kontrollin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e financimit të fushatës zgjedhore të partive politike, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ligjet e sipërcituara.

Në zbatim të kompetencave ligjore dhe referuar nenit 24/4, të Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për Partitë Politike”, i ndryshuar me ligjin nr.90/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580, datë 17.02.2000, “Për Partitë Politike” të ndryshuar, nenit 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.740 datë 31.05.2019 “Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve financiar dhe audituesve ligjorë të cilët do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019” emëroi 34 ekspertë për të kryer monitorimin e fushatës zgjedhore dhe auditimin e 36 partive politike për fondet dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore 2019 dhe 16 kandidatë të mbështetur nga zgjedhësit. Ligji nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për Partitë Politike” i ndryshuar, në nenin 24/3 të tij, parashikoi për herë të parë detyrimin e partive politike për të depozituar në KQZ, brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve raportin për deklarimin financiar të fushatës, duke përfshirë të gjitha degët dhe pjesët e veta përbërëse.

Raporti duhet të përmbajë në mënyrë të saktë:

- a) të ardhurat e përfituara apo që ka në gjendje partia politike, duke përfshirë burimin dhe datën e përfitimit, për periudhën nga caktimi i datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve;
- b) të gjitha shpenzimet e kryera për periudhën nga caktimi i datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve, duke detajuar çdo shpenzim që i është bërë fondit financiar të dhënë për shpenzimet e fushatës zgjedhore;
- c) bilancin e pasurive dhe detyrimeve që ka partia politike, për periudhën nga data e caktimit të datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve.

KQZ me vendimin nr.256, datë 08.05.2019, “Për miratimin e formateve të standartizuara të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore” miratoi formatin e standartizuar dhe udhëzuesin përkatës për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike dhe kandidatët për kryetar bashkie.

Referuar nenit 24/3 të ligjit 8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike” i ndryshuar, data 26 Shtator 2019 ishte afati i fundit i depozitimit të raportit financiar të partive politike. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore morën pjesë 36 parti politike. 23 parti politike kanë dorëzuar raportin financiar në KQZ, nga të cilat 14 parti e kanë dorëzuar brenda datës 26 Shtator 2019 dhe 09 parti politike e kanë dorëzuar jashtë afatit ligjor. 13 parti politike Partia Partia G-99, Partia



Demokrate për Integrim dhe Prosperitet, Partia Pajtimit Kombëtar, Partia Reformave Demokratike Shqiptare, Partia e të Drejtave të Mohuara, Partia Uniteti Kombëtar, Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve, Partia SocialPunëtore Shqiptare, Partia Aleanca Demokristiane Shqiptare, Partia Aleanca Kuq e Zi, Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia Emigracionit Shqiptar, nuk kanë dorëzuar raportin financiar në KQZ.

Ekspertët kontabël të licensuar gjatë zhvillimit të fushatës përpara datës së zgjedhjeve kanë depozituar në KQZ katër raporte të ndërmjetme të monitorimit dhe referuar afatit të përcaktuar në nenin 24/4, pika 2 të Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për Partitë Politike" i ndryshuar me ligjin nr.90/2017, kanë depozituar në KQZ raportet përfundimtare të monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2019.

Ekspertët kontabël të licensuar, referuar afateve të auditimit të përcaktuar në kontratat e lidhura me KQZ, depozituan raportet e auditimit për fondet e përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore 2019.

Ekspertët kontabël në raportet e auditimit shprehin opinionin e tyre në lidhje me respektimin e rregullave dhe ndalimeve të parashikuara nga neni 87/1, neni 89, neni 90 dhe neni 91, pika 2 dhe 3 i Kodit Zgjedhor për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga Partia Politike gjatë fushatës zgjedhore.

Ekspertët financiar në raportet e monitorimit shprehin opinionin e tyre në lidhje me:

- a) Zbatimin e dispozitave ndaluese për financimin e fushatave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për Partitë Politike" i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017;
- b) Dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës së subjektit zgjedhor;
- c) Respektimin e kufirit maksimal të shpenzimeve dhe të kufizimeve sipas llojit, sidomos përsa i përket materialeve propagandistike dhe reklamave televizive;
- ç) Kostimin e veprimtarive të monitoruara me qëllim krahasimin e mëvonshëm me shpenzimet e deklaruara nga subjekti zgjedhor gjatë raportimit;
- d) Rregullat e brendshme të subjektit elektoral për raportimin e shpenzimeve;
- e) Transaksionet financiare të kryera për periudhën 3 muaj përpara dhe pas ditës së zgjedhjeve, nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim evidentimin e transaksioneve të pajustificuara dhe që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore të një ose disa partive politike.

Raportet financiare të partive politike, raportet e auditimit dhe raportet e monitorimit brenda afateve të përcaktuara në udhëzimin e KQZ-së nr. 1, datë 11.04.2019 "Për procedurën e kontrollit dhe verifikimit të financimeve dhe shpenzimeve të partive politike dhe fushatës zgjedhore" janë publikuar në faqen zyrtare të ëeb-it të KQZ-së. KQZ, referuar rregullave të përcaktuara në udhëzimin nr. 1, datë 11.04.2019 "Për procedurën e kontrollit dhe verifikimit të financimeve dhe shpenzimeve të partive politike dhe fushatës zgjedhore", administroi raportet e auditimit dhe raportet e monitorimit dhe shqyrtoi konkluzionet e tyre në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore nga partitë politike në lidhje me financimin.

Gjithashtu mbi bazën e opinioneve të shprehura nga ekspertët kontabël në këto raporte, krahasoi të ardhurat e përfituara dhe shpenzimet e kryera nga partitë politike sipas raporteve me të ardhurat e përfituara dhe shpenzimet e kryera të deklaruar nga partitë politike.

Edhe pse raportet financiare u bënë publike, në KQZ nuk u depozitua asnjë kërkesë ankimore/ denoncim/ pretendim nga partitë politike apo persona të interesuar për shkeljet e rregullave të financimit të fushatës.

Buxheti i KQZ-së për vitin 2020

Me ligjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i janë caktuar fonde në programin Planifikim, Menaxhim dhe Administrim, për vitin në shumën 133.100.000 lekë. Detajimi i zërave të buxhetit është bërë në funksion të përmbushjes së detyrave të strukturave të administratës të KQZ-së, bazuar në realizimin e buxhetit gjatë viteve të kaluara, si për bazë materiale dhe shërbime të ndryshme: shpenzime për paga 86 milionë lekë, shpenzime për sigurime 16.3 milionë lekë, shpenzime për mallra dhe shërbime 29.76 milionë lekë, transfertat korrente të huaja 300 mijë lekë, transfertat për buxhetet familjare dhe individët 240 mijë lekë, investime 500 mijë lekë.

Me Aktin Normativ nr.15, date 15.04.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.88/2019 Për buxhetin e vitit 2020” u bë rishikimi i buxhetit të vitit 2020, ku u bënë pakësimet në zërat e mëposhtëm;

- shpenzime për paga 3 milionë lekë,
- shpenzime për sigurime 1 milionë lekë,
- shpenzime për mallra dhe shërbime 3 milionë lekë

Në zbatim të vendimit nr.4, date 22.02.2020 “Për miratimin e mënyrës së asgjësimit të fletëve të votimit, administrimin e dokumentacionit zgjedhor dhe shpenzimeve buxhetore për hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019” fondet në zërin shpenzime për paga ishin të pamjaftueshme, KQZ bëri rishpërndarjen e fondeve duke pakësuar zërin shpenzime për mallra dhe shërbime me 5.25 milionë lekë dhe duke shtuar zërin shpenzime për paga me 4.5 milionë lekë dhe zërin shpenzime për sigurime me 750 mijë lekë. Fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit u përdorën me efikasitet në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e fondeve publike.

Aktet e miratuara në KQZ, gjatë vitit 2020.

Viti 2020 ishte një periudhë sfidash të shumëllojshme për KQZ-në dhe administratën e saj. Fillimi i vitit u shoqërua me një periudhë të reduktimit të aktivitetit administrativ të KQZ-së për shkak të masave restriktive që shoqëruan periudhën mars – maj të vitit 2020 për shkak të pandemisë. Ndërsa 6-mujori i dytë i veprimtarisë së saj u ndikua nga zhvillimet politike të cilat kulmuan me ndryshimin e arkitekturës të administrimit zgjedhor. Të gjitha këto rrethana ndikuan në performancën e trupës drejtuese të KQZ-së, në aktet e miratuara dhe në gjithë veprimtarinë administrative të zhvilluar prej saj.

Gjatë vitit raportues, vitit 2020, peshën më të madhe të vendimmarrjes së KQZ-së e kanë patur vendimet për



verifikimin e formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve të listave shumemërore të anëtarëve të këshillave bashkiak për shkak të vakancave të krijuara në këto këshilla.

- Në 6 mujorin e parë të vitit 2020, KQZ me strukturën organizative të kohës ka miratuar 13 vendime në përmbushje të detyrimeve të saj ligjore në vijim:

Në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, KQZ ka miratuar 2 (dy) vendime përkatësisht vendimin nr. 4 datë 21.02.2020 “Për miratimin e mënyrës së asgjesimit të fletëve të votimit, administrimin e dokumentacionit zgjedhor dhe shpenzimeve buxhetore për hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30.06.2019” dhe vendimin nr. 5, datë 10.03.2020 “Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2020”.

Në zbatim të ligjit nr. 8580, “Për Partitë Politike”, të ndryshuar KQZ ka miratuar vendimin “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2020”

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publik”, KQZ ka miratuar 4 (katër) vendime për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumemërore për këshillat bashkiak dhe 3 (tre) vendime për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për disa funksionarë publik.

Në zbatim të ligjit nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, KQZ ka shqyrtuar kërkesat e depozituara nga komitetet nismëtare dhe ka marrë 3 (tre) vendime për miratimin dhe shpërndarjen e fletës tip sipas kërkesave të komiteve nismëtare për propozimin e projektligjit “Për referendimet në Republikën e Shqipërisë”, për propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe për propozimin e projektligjit “Për krijimin e regjistrit kombëtar të autorëve të krimeve seksuale”.

6 mujori i dytë i vitit 2020 i cili u shoqërua me ndryshimin e kornizës ligjore të kodit Zgjedhor dhe implementimin e një arkitekture të re të administrimit zgjedhor, të cilat diktuan detyra të shtuara në një periudhë shumë të shkurtër kohore dhe gjeneruan një dinamizëm më të lartë të procesit administrativ. Pas shpalljes së dekretit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, nr. 11700, datë 06.09.2020, për caktimin e datës 25 Prill 2021, si datë për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin, u krijuan dhe konstituan organet e reja drejtuese të KQZ-së të cilat udhëheqin aktivitetin e saj administrativ dhe rregullator në funksion të organizimit, administrimit dhe kontrollit të procesit zgjedhor.

Për shkak të ndryshimeve ligjore, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve u përballë me një sfidë me kohën për të miratuar në zbatim të kërkesave të reja ligjore akte nënligjore të shumta të cilat do të rregullonin marrëdhëniet e caktuara për herë të parë, si dhe të rishikonin aktet në fuqi si pasojë e ndryshimeve në ligj ose nevojave të lindura nga praktikatat e mëparshme



zgjedhore, apo që diktohen nga rekomandimet e OSBE/ODIHR për zgjedhjet. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përgjatë aktivitetit të saj në hartimin e projektakteve u udhëhoq nga parimi efencës dhe efikasitetit duke reduktuar numrin e akteve të hartuara dhe duke rritur cilësinë e tyre, në mënyrë të tillë që të jenë sa më të kuptueshme për partitë politike dhe për çdo të interesuar.

Gjatë 6 mujorit të dytë organet e reja drejtuese të KQZ-së kanë miratuar 54 akte nënligjore.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar përgjatë kësaj periudhe 40 vendime dhe 1 udhëzim. Nga këto vendime 22 vendime janë marrë në zbatim të ligjit 138/2015, 15 vendime në funksion të organizimit të zgjedhjeve të datës 25 prill 2021 dhe 2 vendime administrative për shtyrjen e afatit të nënshkrimeve të komiteteve nismëtarë në zbatim të ligjit nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni Rregullator në KQZ ka miratuar 13 akte nënligjore, 11 vendime dhe 2 udhëzime në funksion të organizimit të zgjedhjeve të datës 25 prill 2021. Ndër vendimarrjet kryesore të Komisionit Rregullator në KQZ përgjatë kësaj periudhe janë:

- Vendim nr. 01, datë 26.10.2020, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator”.
- Vendimi nr. 02, datë 31.10.2020, “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e indentifikimit elektronik të zgjedhësve që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendim nr. 03, datë 06.11.2020, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.
- Vendimi nr. 04, datë 13.11.2020, “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”;
- Vendim nr. 10, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave dhe modaliteteve për llogaritjen e vlerës monetare të dhurimeve në natyrë ose shërbimeve, huave dhe kredive për qëllime zgjedhore ose politike të përfituara nga partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatës zgjedhore”.
- Udhëzim nr. 02, datë 05.12.2020, “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në KZAZ dhe KQV”.



Verifikimi formularëve të vetëdeklarimit të funksionarëve publik (dekriminalizimi) në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” për vitin 2020.

Vendimmarrja e KQZ për vitin 2020, në pjesën më të madhe të saj, lidhet me zbatimin e ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Ligji përmban dispozita të cilat garantojnë integritetin e figurës së kandidatëve, duke ndaluar kandidimin për tu zgjedhur në funksionet publike të deputetit, kryetarit të bashkisë ose anëtarit të këshillit bashkiak, të personave të cilët janë në kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë për shkak të ligjit.

Kandidatët për anëtar në këshillat bashkiak, u verifikuan në përputhje me ligjin nr. 138/2015 dhe vendimin e Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015”, brenda afateve të përcaktuara ligjore.

Për vitin 2020 Komisioni Qendror të Zgjedhjeve ka administruar 83 (tetëdhjetë e tre) formularë vetëdeklarimit për zëvendësimin e vakancave të krijuara në këshillat bashkiak.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda kompetencave të veta kërkoi informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, përkatësisht për historinë e ndryshimit të gjenealiteteve dhe për gjendjen gjyqësore të tyre.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka përfunduar verifikimin e 72 (shtatëdhjetë e dy) kandidatëve nga të cilët 39 kandidatë janë të gjinisë mashkullore dhe 33 kandidate janë të gjinisë femërore.

Për shqyrtimin e rezultateve të verifikimit referuar më lart, KQZ përgjatë vitit 2020 ka miratuar 26 (njëzetë e gjashtë) vendime.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për këto raste ka konstatuar se kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak nuk janë në kushtet e moszgjedhshmërisë dhe ka plotësuar vakancat në këshillat bashkiakë.

Përgjatë vitit 2020 kanë refuzuar depozitimin e formularit të vetëdeklarimit për vazhdimin e procedurave të mëtejshme të verifikimit 38 (tridhjetë e tetë) kandidatë të listave shumëme të subjekteve të ndryshme politike.

Shqyrtime të rezultateve të verifikimeve të Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2020

Në vitin 2020 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka administruar rezultatet e verifikimit të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, për 4 (katër) raste. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për 1 (një) rast ka vendosur shpalljen e pavlefshmërisë dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit për anëtarin e këshillit bashkiak, për 1 (një) rast ka vendosur se anëtari i Këshillit të Bashkisë nuk përfshihet në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji nr. 138/2015 dhe për 2 (dy) raste ka deklaruar të përfunduar procedurën administrative pa vendim përfundimtar për shkak të dorëheqjes së funksionarëve publikë.



Aktivite me Partnerë Ndërkombëtarë

Grupi Ndërkombëtar i Punës për Zgjedhjet (Election Working Group)

Në kuadër të transparencës dhe vendosjes së një bashkëpunimi permanent me organizmat ndërkombëtarë që operojnë në fushën e zgjedhjeve, KQZ është pjesë e Election Working Group (EWG), krijuar me iniciativën e Prezencës së OSBE-së, pjesë e të cilit janë ambasadat e shteteve anëtare të OSBE-së dhe Organizatat Ndërkombëtare në Shqipëri, të cilat kanë pjesë të aktivitetit të tyre edhe fushën zgjedhore.

Mbledhjet mujore të këtij grupi pune, të krijuar që nga vitin 2012, shërbejnë për informimin nga titullari i KQZ-së për veprimtarinë institucionale, problematikat dhe sfidat e ndeshura, koordinimin e projekteve dhe asistencën e partnerëve për realizimin e tyre.

Gjatë vitit 2020 asistenca e partnereve ndërkombëtar ka konsistuar në realizimin e disa aktiviteteve në nivel lokal, mbështetje me ekspertizë të huaj si dhe organizimin e seminareve për ngritjen e kapaciteteve të administratës së KQZ-së. Në kuadër të strukturës horizontale të Këshillit të Evropës / Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, projekti "Veprimi kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri" kontribuoi në forcimin e legjislacionit për financimin e Partive Politike dhe Fushatave Zgjedhore. Projekti i realizuar me ekspertizën e KiE dhe NDI dhe mbështetjen financiare të BE dhe Ambasadës britanike, mbështeti kapacitetet mbikëqyrëse të KQZ-së për kontrollin dhe verifikimin e raporteve financiare të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore përmes: hartimit të kuadrit rregullator dhe metodologjik, përkrahjen e KQZ-së në hartimin e akteve nënligjore (udhëzimeve) pas ndryshimeve në Ligjin për Partitë Politike si dhe ngritjes së kapaciteteve të ekspertëve financiarë të KQZ-së me monitorimin e financimit të fushatës zgjedhore në mënyrë efektive.

Ndarja e eksperiencave pozitive në trajtimin e mjaft problematikave me të cilat përballen sot Trupat e Menaxhimit të Zgjedhjeve në rajon e më gjerë me synim shkëmbimin e përvojave dhe nxjerrjen e mësimave pozitive ka qenë dhe fokusi i aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2020. Një pjesë e këtyre aktiviteteve janë zhvilluar dhe në platformat online për shkak të situatës jo të zakonshme të krijuar nga pandemia. Ndër aktivitetet më të rëndësishme janë si vijon;

- **Varshavë më 28 dhe 29 janar 2020.** Në kuadër të projektit "Mbështetje e zgjedhjeve në Ballkanin Perëndimor", Departamenti i Zgjedhjeve ODIHR organizoi seminarin "Një perspektivë nën-rajonale për adresimin e rekomandimeve për zgjedhjet në lidhje me regjistrimin e votuesve - sfidat dhe praktikatat më të mira".
- **Mbretëria e Bashkuar më 5 deri 8 Shkurt** Në kuadër të programit të mbështetur nga Ambasada Britanike, NDI organizoi një vizite studimore në Londër, Qëllimi i vizitës ishte për të parë nga afër rregullimet ligjore dhe eksperiencën e tyre në fushën e financave politike përfshirë edhe praktikatat që ndjek rregullatori për mbikëqyrjen e financave të subjekteve zgjedhore.



- **Republika Çeke më 10 deri 12 Shkurt 2020.** Trainimi i Lidershipit Zgjedhor për Evropën Qendrore dhe Lindore në Pragë, Ky trajnim ishte pjesë e programit të Administratës Rajonale të Zgjedhjeve dhe Forcimit të Procesit Politik (REAPPS II), i hartuar me mbështetjen e USAID për të adresuar sfidat e përbashkëta në Evropën Qendrore, Lindore dhe Euroazinë.
- **Pragë, Republika Çeke më 3 dhe 4 Shkurt 2020** Seminar me temë "Mbikëqyrja efektive e financave politike" nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES), Zyra Rajonale e Evropës
- **Sloveni ,webinari dy ditor 10-11 nëntor 2020** në kuadër të projektit dy-vjeçar "Forcimi i transparencës së Trupave të Menaxhimit Zgjedhor; Shkëmbimi i përvojave dhe mësimet e nxjerra midis Shqipërisë dhe Sllovenisë" (2019-2020)
- Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim–Asociimit, përshpejtimit të procesit të integritimit dhe angazhimit të Komisionit Evropian për intensifikimin e mbështetjes për Shqipërinë, u zhvillua në Bruksel takimi i Nënkomitetit të Bashkimit Evropian-Shqipëri me temë 'Drejtësia, Liria dhe Siguria. Përfaqësuesi i KQZ raportoi lidhur me zbatimin e Reformës Zgjedhore e në mënyrë të vecantë duke u ndalur në identifikimin biometrik të votuesve, votimin dhe numërimin elektronik, votimin e emigrantëve si dhe financimin e partive politike.
- **Tbilisi, Gjeorgjia me 8-10 shtator 2020** u organizua Konferenca vjetore e 29-të e ACEEEO-s me pjesëmarrjen aktive të zyrtarëve të zgjedhjeve, akademisë dhe aktorëve të tjerë të interesuar në zgjedhje, ne focus ishte tema 'Zgjedhjet dhe Komunikimet - Roli i Organeve të Menaxhimit Zgjedhor në kryerjen dhe lehtësimin e komunikimit efektiv'. Në situatën aktuale ndërkombëtare, e cila lidhet me përhapjen e virusit COVID-19, konferenca u zhvillua online ku ndërveprimi virtual ju ofrua të gjithë pjesëmarrësve te regjistruar,

Me ndryshimet e reja të Kodit Zgjedhor si dhe ristrukturimit të KQZ-së e gjithë veprimtaria e Drejtorisë së Komunikimit është përqëndruar në përgatitjet e zgjedhjeve për Kuvend 25 prill 2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në kuadër të transparencës dhe informimit ka zhvilluar takime me Ambasadorët e akredituar në vendin tonë të cilët janë informuar lidhur me përgatitjet intensive të zgjedhjeve si dhe sfidat me të cilat ndeshet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Në këto takime si dhe në takimet protokollare të realizuara me Ambasadorët e SHBA-së, Gjermanisë, Italisë, Spanjës, Austrisë, Mbretërisë së Bashkuar, Hollandës, Greqisë janë shprehur në mbështetje të procesit duke e konsideruar mbajtjen e zgjedhjeve të lira e demokratike si test për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka qenë transparent në raport dhe me shoqërinë civile lidhur me procedurën e miratimit të akteve. Çdo akt para miratimit është dërguar për mendim tek organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e partive politike të pranishme në KQZ, me qëllim përmirësimin e drafteve të mëparshme dhe pasqyrimin e shqetësimeve të tyre



mbi çështjet. Komisioneri ka zhvilluar takime konsultative me përfaqësues të organizatave lokale ku janë ngritur shumë çështje të cilat janë adresuar në mënyrë të menjëhershme nga titullari i institucionit.

Administrimi i dokumentacionit zgjedhor; të zgjedhjeve vendore 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.4, datë 21.02.2020, vendosi hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019.

Për shkak të situatës së shkaktuar nga pandemia, masave dhe protokolleve të zbatuara për mbrojtjen e shëndetit të popullatës, puna për hapjen e kutive të votimit dhe përpunimin e dokumentacionit zgjedhor të zgjedhjeve vendore 2019, u krye në muajin qershor 2020.

Hapja e 5401 kutive të votimit, 5401 kutive të materialeve zgjedhore, u krye sipas procedurave ligjore, u administrua dokumentacioni zgjedhor i parashikuar në nenin 178, pika 6 të Kodit Zgjedhor, si dhe u asgjësuan fletët e votimit me riciklim të letrës, sikundër përcaktuar në vendimin e KQZ-së nr. 4, datë 21.02.2020.

Bazuar në nenin 178, pika 6, të Kodit Zgjedhor, dhe procedurës së përcaktuar nga KQZ me vendimin nr.4 datë 21.02.2020, u përpunua dokumentacioni zgjedhor i çdo QendreVotimi si më poshtë:

1. Lista e Zgjedhësve
2. Regjistri i posaçëm i zgjedhësve
3. Libri i protokollit KQV-së
4. Procesverbal i hapjes së votimit
5. Procesverbal i mbylljes së votimit

I gjithë dokumentacioni është administruar në dosje më vete, duke identifikuar numrin e QV-së, ZAZ-së, qarkun që i korrespondon, numrin e fletëve të administruara dhe afatin e ruajtjes. Më pas dosjet janë organizuar dhe dorëzuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, me ruajtje RHK.

Në zbatim të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, dokumentacioni i zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore 2019, i skanuar, është administruar në arkivën elektronike të KQZ.

Edukimi i shtetasve të interesuar për çështje të administrimit zgjedhor

Edukimi i shtetasve të interesuar për çështje të administrimit zgjedhor, një nga fokuset kryesore të punës së KQZ në vit jo zgjedhor, u ndikua dhe u përshtat sipas kushteve të diktuara nga situata e pandemisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si një praktikë të konsoliduar institucionale, celebroi Ditën Botërore të Zgjedhjeve më 6 Shkurt 2020. Pjesëmarrës në celebrimet e kësaj dite, organizuar në ambientet e institucionit, ishin aktiviste të shoqatës “Gratë dhe Fëmijët”, të rinj aktivistë të Institutit të Kulturës Rome, aktivistë të organizatave të personave me aftësi ndryshe, studentë të departamentit të gazetarisë, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Univeristeti i Tiranës, dhe maturan të



të shkollave të mesme “Qemal Stafa” dhe “Andon Zako Çajupi”.

Celebrimi i kësaj dite me simbolikë të veçantë me përfaqësues të grupimeve shoqërore specifike, synoi fokusimin në problematikat që ndeshin këto grupe në procesin zgjedhor, dhe diskutimin për mënyrat, mjetet dhe format, përdorimi i të cilave në veprimtaritë edukuese dhe trajnuese të KQZ-së do të ndikonte në ritjen e efektivitetit të tyre.

Të pranishmëve, në simbolikën e kësaj dite, iu përcollën mesazhet të rëndësishme për rëndësinë e zgjedhjeve demokratike dhe votës së lirë dhe të pandikuar.

Duke bërë protagonistë të këtij celebrimi të rinjtë, si dhe përfaqësues të grupimeve të tjera shoqërore, u bashkëbisedua për rëndësinë e përfshirjes në proceset zgjedhore, si votues i përgjegjshëm dhe qytetar aktiv, kontribut i cili i bën shërbimin më të mirë forcimit të demokracisë në vend. Pjesëmarrësit, theksuan nevojën për realizimin e sa më shumë projekteve për informimin, sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve në përgjithësi, dhe zgjedhësve më aftësi ndryshe në veçanti.

Axhenda e veprimtarive përfshiu studentët e gazetarisë, me trajtimin e temës “Gazetarët në zgjedhje; Të informojmë dhe të jemi të informuar për zgjedhjet”, si dhe maturantët me trajtimin e temës “Rëndësia e zgjedhjeve demokratike, vlera e votës së lirë, të drejtpërdrejtë dhe të pandikuar”.

Të rinjtë u bënë pjesë e aktive në trajtimin e temës dhe përmes diskutimeve u informuan dhe sensibilizuan për rëndësinë që ka vota e lirë, e fshehtë dhe e pandikuar në zhvillimin e proceseve demokratike për të ardhmen e vendit. Përfitimit të njohurive për procesin zgjedhor i shërbeu edhe konkursi i realizuar mes të rinjve të dy shkollave, ku përmes pyetësorit të përgatitur të rinjtë provuan nivelin e njohurive të tyre për zgjedhjet.

Sesione të edukimit zgjedhor janë zhvilluar edhe në qytetin e Durrësit, me mbi 100 maturantët e Shkollës së Mesme Industriale “Beqir Çela”. Të rinjtë vlerësuan rëndësinë e trajtimit të temave që lidhen me zgjedhjet, që si profesionistë të së nesërme të jenë të mirë informuar dhe të ndërgjegjshëm për ushtrimin e rolit të tyre qytetar për demokracinë në vend. Situata e pandemisë pamundësoi realizimin e veprimtarive të edukimit të shtetasve për administrim zgjedhor, sipas planifikimit për vitin 2020.

Në kushtet e krijuara nga virusi Covid-19, shtetasit e interesuar për trajnim për çështje të administrimit zgjedhor, aplikuan në faqen zyrtare të KQZ-së në rubrikë të veçantë “apliko për trajnim”, dhe përmes platformës zoom u organizuar disa sesione edukimi për çështje të administrimit zgjedhor.

Plani i veprimeve, bazë orientuese për mbarëvajtjen e punës

Organizimi dhe administrimi i procesit zgjedhor, kërkon përballimin e një volumi të madh të punëve, në afate të ngushta kohore, dhe për rrjedhojë përballimin e jo pak sfidave. Risitë që do të këtë procesi zgjedhor i datës 25 Prill 2021, sipas ndryshimeve të Kodit Zgjedhor me ligjet nr. 101/2020, datë 23.07.2020, dhe 118/2020, datë 5.10.2020, e bënë më sfiduese dhe komplekse punën e KQZ, dhe të administratës së saj.

Pas dekretimit nga Presidenti i Republikës të datës së zgjedhjeve 25.04.2021, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin,



u përgatit plani orientues i veprimeve në bazë dhe për zbatim të Kodit Zgjedhor, duke evidentuar në kronologji akteve të nevojshme, aftet ligjore dhe organin drejtues kompetent për miratimin e tyre, si edhe afatet për veprimet operacionale në përmbushje të detyrave konkrete.

Përcaktimi i datave konkrete, sipas afateve kohore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, si edhe përcaktimi i veprimeve të nevojshme dhe datave kur ato duhet të realizohen, shërbejnë si bazë për përmbushjen korrekte të detyrave dhe përgjegjësive, veçanërisht sa i përket ngritjes, organizimit dhe koordinimit të veprimtarisë të administratës zgjedhore në të tre nivelet.

Infrastruktura zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021

Legjislacioni zgjedhor parashikon që për çdo proces zgjedhor infrastruktura mbështetëse ngrihet tërësisht sipas një mekanizmi, kriteresh, afatesh dhe ndërveprimi institucional të mirëpërcaktuar. Respektimi i kërkesave dhe kriterëve ligjore për vendndodhjen e qendrave të votimit, Selive të Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor, vendeve të numërimit të votave, apo ambienteve që do të përdoren për trajnimin e komisionerëve zgjedhorë, përbëjnë thelbin e administrimit të mirë të procesit.

Ndërtimi i infrastrukturës mbështetëse me ndërveprimin e disa institucioneve, kërkon menaxhim të mirë burimesh dhe energjish për të përballuar volumin e madh të punëve dhe përgatitjeve, veçanërisht në këto kohë ku virusi SARS-CoV ende në qarkullim në shkallë botërore, po bën që shoqëritë të përjetojnë dhe të përgatiten për “realitete të reja”, të ndryshme nga sa janë njohur e përjetuar deri tani.

Sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, nenit 62 dhe 93 të tij, vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, në ndërtesa ku janë të vendosura institucione arsimore, kulturore dhe shëndetësore, përjashtuar rastet e pamundësisë për arsye objektive, të parashikuara në dispozitat referuese.

Me objektiv kryesor mbrojtjen e jetës të çdo komisioneri, zgjedhësi dhe vëzhguesi, KQZ ka vlerësuar si të një rëndësie të veçantë kushtet që duhet të ofrojnë ambientet që do të përdoren për zgjedhjet e datës 25.04.2021, me qëllim respektimin rigoroz të protokolleve shëndetësore.

Gjithashtu, përdorimi i sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021, ku identifikimi elektronik do të shtrihet në 100 përqind të votuesve, dikton nevojën që qendrat e votimit të ofrojnë infrastrukturën e nevojshme për funksionimin pa probleme të teknologjisë që do të përdoret. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mbi bazë të këtij vlerësimi dhe në ushtrim të kompetencave të veta, më datë 11 Nëntor 2020, adresoi për të gjithë Kryetarët e Vetqeverisjes Vendore, kërkesën për dërgimin e të dhënave për infrastrukturën zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Kjo kërkesë iu dërgua për dijeni edhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, përsa si qendra votimi, Seli të KZAZ-ve, vende të numërimit të votave, si edhe për trajnimet e administratës zgjedhore, kryesisht përdoren ambientet e shkollave. Informacioni u kërkuar të dërgohej sipas formularëve të strukturuar për të pasqyruar të gjithë të dhënat e nevojshme, si sipërfaqja, vendndodhja, kati, numri i



dritareve dhe rrjeti elektrik i ambientit, numrin e zgjedhësve më aftësi të kufizuar për çdo qendër votimi, dhe llojin e paaftësisë. Kryetarët e Bashkive, në jo pak raste pas përsëritjes së kërkesës nga ana e KQZ-së, dërguan informacionin dhe të dhënat e kërkuara, duke ndihmuar punën përgatitore të KQZ në këtë aspekt kaq të rëndësishëm për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Mbi bazë të këtyre të dhënave KQZ krijoi edhe data-baze për qendrat e votimit ku janë të regjistruar zgjedhës me aftësi të kufizuar, me qëllim për të planifikuar dhe prodhuar mjetet e posaçme që i nevojiten këtij grupimi gjatë procesit të votimit, si dhe u mundësua për të ndërhyrë në kohë që të gjitha qendrat e votimit ku këta zgjedhës janë të regjistruar të vendosen në katet e para të objekteve.

KQZ, me shqetësim vlerëson situatën sa i përket mungesës së rampave në shumicën e objekteve publike ku janë caktuar qendrat e votimit, shkolla apo institucione shëndetësore. Kjo problematikë, bërë prezent nga KQZ në vijimësi, ende e pa zgjidhur, kërkon adresim dhe masa konkrete nga institucionet që kanë në pronësi apo përgjegjësi administrimi këto objekte.

Bashkëpunimi me organet e vetqeverisjes vendore, marrja e informacionit për QV-të, zgjedhësit në to, hartat zgjedhore, QV-të në ambiente private.

Komisioni Rregullator me udhëzimin nr. 01, datë 05.12.2020, përcaktoi rregullat për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetqeverisjes vendore për zgjedhjet për Kuvend të dates 25 prill 2021.

Në zbatim të ndryshimeve ligjore për numrin e zgjedhësve për qendrën e votimit, nga jo më pak se 200 në jo më pak se 300 zgjedhës, jo pak qendra votimi shkrihen dhe bashkohen me qendrat e votimit me numër më të madh zgjedhësish. Për zbatim të kriterit ligjor të numrit minimal të zgjedhësve që duhet të ketë qendra e votimit, kryetarët të disa Bashkive, territoret e të cilave përfshijnë zona me relief gjeografik malor dhe distanca të konsiderueshme, referuan në KQZ problematika të ndeshura gjatë këtij procesi. Shqetësimi i shprehur, për të cilën kërkohej edhe zgjidhja nga KQZ, ka të bëjë me distancën që zgjedhësit do të duhet të përshkujnë për të votuar në qendrën e re të votimit, e cila shkon përtej 5 km, madje në një rast në 17 km. Këtyre situatave të faktit, Kuvendi duhet t'i japë zgjidhje përmes ndryshimeve përkatëse të ligjit, për të ofruar zgjidhje për zgjedhësit e këtyre zonave të qendrave të votimit, të cilët duke qënë përgjithësisht të moshuar do ndeshin vështirësi për të ushtruar të drejtën e tyre të votës në qendrat e votimit ku janë të regjistruar, të cilat janë në distanca të largëta nga vendbanimet e tyre.

Kryetarët e Bashkive, sikundër edhe në proceset zgjedhore pararendëse, nuk respektojnë afatet ligjore për dërgimin e propozimeve për caktimin e qendrave të votimit në ndërtesa private, për rastet e pamundësisë të përdorimit të një ndërtese publike në zonën e qendrës së votimit apo në një zonë qendre votimit fqinjë. Në këtë procedurë, Bashkitë e Durrësit, Krujës dhe Tiranës, kanë patur vështirësi objektive, pasi për shkak të pasojave të tërmetit të nëntorit 2019, kanë numër të madh shkollash jashtë funksionit e për rrjedhojë kanë konsumuar më shumë kohë për të identifikuar dhe vlerësuar objektet e përshtatshme ku do të caktohen qendrat e votimit që në zgjedhjet e mëparshme kanë patur vendndodhjen në shkolla.



Megjithë kërkesat e përsëritura për respektim të afateve në rastet e propozimit të caktimit të QV në ndërtesë private, për dërgimin e të dhënave sipas një formulari të strukturuar nga KQZ me qëllim pasqyrimin e plotë dhe të saktë të tyre, edhe në mbyllje të vitit 2020 nuk u disponua me vendim asnjë rast nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shkak të mungesës së propozimeve në fomën e kërkuar nga ligji.

KQZ vlerëson se rregullimi ligjor për caktimin e një nëpunësi ndërlidhës me KQZ në administratën e bashkisë, është e nevojshme për të kordinuar dhe bashkërenduar punën sa i përket caktimit dhe vendndodhjes së qendrave të votimit.

Aktet rregullatore për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve për Kuvendin të datës 25 Prill 2021

1. Akte të miratuara nga Komisioni Rregullator

1.1 Për organizimin dhe funksionimin e administratës zgjedhore

Një proces zgjedhor demokratik përcaktohet nga qytetarët aktivë së pari si votues, vëzhgues, kandidatë, por edhe si komisionerë zgjedhorë apo numërues votash të cilët duke ju përmbajtur parimeve të ligjshmërisë, pavarësisë, paanësisë, ndershmërisë, sjelljes etike, transparencës dhe llogaridhënies rrisin besimin publik në administrimin e procesit zgjedhor. Në këtë kuadër, vëmendje e veçantë i është kushtuar hartimit dhe miratimit të akteve për organizimin dhe funksionimin e administratës zgjedhore, veçanërisht për komisionet e zonave të administrimit zgjedhor, në vlerësim të detyrave të rëndësishme që ky nivel i administratës zgjedhore kryen për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në Zonën e Administrimit Zgjedhor (ZAZ). Kryerja e detyrave dhe përmbushja e përgjegjësisë nga KZAZ, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, ndërvaret nga shkalla e administrimit profesional dhe jo-partiak të procesit, si dhe nga transparenca e plotë së ofruar për vëzhguesit e akredituar, të partive politike, të shoqërisë civile apo të organizatave ndërkombëtare.

Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe miratuar nga Komisioni Rregullator me vendimin nr. 5, datë 20.11.2020, është një akt normativ që përcakton dhe detajon jo vetëm rregullat për organizimin dhe funksionimin e punës dhe të mbledhjeve të KZAZ, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, por përmban edhe normat për sjelljen etike të komisionerëve, trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, si edhe parashikime për kryerjen e veprimtarisë në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së fatkeqësisë natyrore apo të pandemisë.

Akt i rëndësishëm së veçantë ishte miratimi nga Komisioni Rregullator i projektvendimit të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Komisionet e Qendrave të Votimit”.

Ky udhëzim, në zbatim të frymës dhe normave të Kodit Zgjedhor, por edhe të në referim “Garancive procedurale” të



Kodit të Praktikave të Mira për Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, përcaktoi rregullat dhe detajoi procedurat për emërimet kryesisht, si në rastet kur ato zbatohen nga KQZ apo nga KZAZ, në funksion të sigurisë dhe rritjes së transparencës për përzgjedhjen e shtetasve për emërim kryesisht.

KQZ ka kryer njoftimet publike për shprehje të interesi nga shtetas të interesuar për tu emëruar kryesisht anëtarë apo sekretarë të KZAZ-ve.

1.2 Akte për procedurat që zbatohen në zgjedhje

- Komisioni Rregullator ka miratuar me vendimin nr. 11, datë 28.12.2020 “Për caktimin e rregullave për administrimin dhe shpërndarjen e vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit”, projektakt i paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, i cili përcakton normat dhe porocedurat për administrimin dhe shpërndarjen e vulës rezervë për Komisionin e Qendrës së Votimit, një material zgjedhor i rëndësisë së veçantë, për shmangien e rasteve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve në QV apo të pavlefshmërisë së fletës së votimit.

Akte të miratuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Në zbatim të kompetencave të tij, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka disponuar:

1.1. Për ngritjen dhe funksionimin e administratës zgjedhore

- “Caktimi i partive politike që do të propozojnë anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”, vendimi nr. 40, datë 23.12.2020. Renditja e partive parlamentare për efekt të ndarjes së vendeve në KZAZ, u bazua në parashikimet e nenit 29, paragrafët 1 dhe 4, nenit 183, paragrafi 8, të Kodit Zgjedhor, vendimin nr. 555, datë 26.07.2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017”, si dhe në informacionin e dërguar nga Kuvendi i Shqipërisë me shkresën nr. 2107/1 prot., datë 27.11.2020.

“Miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës së Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”, vendimi nr. 37, datë 17.12.2020; Ky dokumentacion është i plotë për dokumentimin e punës, veprimtarisë dhe vendimmarrjes së Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, si dhe të shpërndarjes dhe dorëzimit të materialit zgjedhor, në respektim të nenit 33 e vijues të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

- “Caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”, vendimi nr. 38, datë 17 Dhjetor 2020;
- “Caktimin e njësive administrative ku do të krijohen Selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit



Zgjedhor”, vendimi nr. 32, datë 16.12.2020.

Referuar juridiksionit territorial të secilës prej 92 Zonave të Administrimit Zgjedhor që do të funksionojnë për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, duke analizuar dhe vlerësuar:

- shtrirjen dhe relievin gjeografik të Zonave të Administrimit Zgjedhor;
- numrin dhe pozicionin gjeografik të njësive administrative të përfshira në territorin e Zonave të Administrimit Zgjedhor;
- lehtësitë logjistike të transportit rrugor;
- praktikatat e zgjedhjeve të mëparshme;

njësitë administrative të përcaktuara për krijimin e Selive të KZAZ-ve, ofrojnë barazlargësi nga qendrat e votimit në juridiksion e ZAZ-së përkatëse, dhe lehtësi logjistike të transportit rrugor.

Ky vendim iu përcoll menjëherë Kryetarëve të Bashkive, me të cilët u bashkëpunua për krijimin e kushteve optimale për punën e KZAZ-ve, kjo sa i përket ambienteve, dhe mjeteve të punës.

Për logjistikën zgjedhore

- “Miratimin e modelit dhe specifikimeve teknike të dhomave të fshehtësisë”, vendimi nr. 33, datë 16.12.2020. Specifikimet teknike të miratuara, bëjnë që dhomat e fshehta të garantojnë fshehtësinë e votimit, të jenë të përshtatshme për zgjedhësin gjatë shënimit të fletës së votimit, të ofrojnë lehtësi për komisionerët në organizimin e qendrës së votimit. Modeli dhe specifikimet teknike të dhomave të fshehta për zgjedhësit me aftësi të kufizuar janë konsultuar përpara miratimit me organizata përfaqësuese të këtij grupimi zgjedhësish, për të qënë sa më të përshtatshme për ta.

- “Miratimin e modelit dhe specifikimeve të kutive të votimit dhe kutive të materialeve të votimit që do të përdoren për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”, vendimi nr. 36, datë 17.12.2020. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administron në numër të mjaftueshëm të kutive të votimit dhe të kutive të materialeve zgjedhore, të cilat do të ripërdoren edhe në këtë proces zgjedhor. Kutitë e votimit kanë volum 83 litra, dhe kutitë e materialeve zgjedhore kanë volum 60 litra, kanë kapacitet të mjaftueshëm për fletët e votimit dhe për materialet zgjedhore, janë rezistente dhe nuk ka pasur problematikë gjatë transportit të tyre.

- “Miratimin e modelit dhe specifikimeve të vulave me kod sigurie që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”, vendimi nr. 35, datë 16.12.2020. Modeli dhe specifikimet teknike të këtij materiali të rëndësishëm zgjedhor, të njëjta me ato të zgjedhjeve të mëparshme, garantojnë integritetin e kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutive të materialeve të votimit, sikundër ofrojnë lehtësi në administrimin dhe përdorimin e tyre nga komisionerët zgjedhorë, gjatë shpërndarjes, kryerjes së procedurave në qendrën e votimit, si dhe gjatë procesit të numërimit të votave.

- “Miratimi i specifikimeve të lëndës së posaçme për timbrimin e zgjedhësve”, vendimi nr. 34, datë



16.12.2020. Model dhe specifikimet e lëndës së posaçme për timbrimin e zgjedhësve janë të njëjtat me ato të përdorura në zgjedhjet pararendëse, tip “marker”, me përmbajtje 20% nitrat argjendi, me efekt të menjëhershëm, e dukshme me shikim të lirë, rezistente për më shumë se 24 orë, e pacënueshme nga çdo veprim i jashtëm, dhe njëherazi e padëmshme për organizmin.

